VENDIM
Nr. 187, datë 9.3.2016

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR GJYKATËN E APELIT ADMINISTRATIV TIRANË, TË ISH-GODINËS SË MINISTRISË SË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c', të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Ministria e Drejtësisë, për mjedise pune për zhvillimin normal të veprimtarisë administrative të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit.

2. Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë apo t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Vendimi nr. 729, datë 2.9.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të mjediseve të ish-godinës së Ministrisë së Mjedisit, për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi